



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

VENDIM

Nr. 515, datë 24.09.2024

PËR

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 205, DATË 17.04.2024 “PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË PËRZGJEDHJES TË KANDIDATËVE PËR LËVIZJE PARALELE NË GJYKATËN E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM ELBASAN, DURRËS DHE TIRANË PËR POZICIONET E SHPALLURA TË LIRA, PËRKATËSISHT ME VENDIMET NR. 249, DATË 24.05.2023; NR. 22, NR. 23 DATË 18.01.2023 DHE NR. 73, 74, 75, 76, 77, 78, 79, 80, 81, 82, 83, 84,85 DHE 86 DATË 20.02.2024 TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR”

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a, pika 1, shkronja “e”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 86, shkronja “ç”, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 8, pikat 2 dhe 3, nenin 43 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Kreun IV dhe V të vendimit të tij nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, vendimin nr. 205, datë 17.04.2024 “Fillimin e procedurave të përzgjedhjes të kandidatëve për lëvizje paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Durrës dhe Tiranë për pozicionet e shpallura të lira, përkatësisht me vendimet nr. 249, datë 24.05.2023; nr. 22, nr. 23 datë 18.01.2023 dhe nr. 73, 74, 75, 76, 77, 78, 79, 80, 81, 82, 83, 84, 85 dhe 86 datë 20.02.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, vendimin nr. 361, datë 29.07.2024 “Për deklarimin e mbarimit të mandatit të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor z. Alban Toro”,

VENDOSI:

1. Ndryshimin pjesërisht të pikës 2 të vendimit nr.205, datë 17.04.2024 “Për fillimin e procedurave të përzgjedhjes të kandidatëve për lëvizje paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Durrës dhe Tiranë për pozicionet e shpallura të lira, përkatësisht me vendimet nr. 249, datë 24.05.2023; nr. 22, nr. 23 datë 18.01.2023 dhe nr. 73, 74, 75, 76, 77, 78, 79, 80, 81, 82, 83, 84,85 dhe 86 datë 20.02.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, nënpika “a”, si më poshtë:

- Për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 76, datë 20.02.2024, nr.80, datë 20.02.2024, nr.84, datë 20.02.2024, nr. 78, datë 20.02.2024, nr. 85, datë 20.02.2024 – relator, z. Albens Tabaku.

2. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet kandidatëve të përfshirë në pikën 1 të këtij projektvendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR